

KOSOVO GREEN ACTION



FORUMI I GJELBËR I DYTË DOKUMENT ZOTIMI

MAJ
2025



OBJEKTIVI I DOKUMENTIT



Projekti "Kosovo Green Action" është i përkushtuar të avancojë qasjen publike në informacion, të nxisë bashkëpunimin shumëpalësh, të rrisë llogaridhënien dhe të mbështesë shërbime që përpunohen me Agjendën e Gjelbër.

Kosova ndodhet në një moment vendimtar në rrugëtimin e saj drejt tranzicionit të gjelbër. Si një vend në zhvillim, ka mundësinë unike të përfitojë nga praktikat më të mira globale në hartimin e politikave dhe investimeve të qëndrueshme. Në të njëjtën kohë, Kosova përballet me sfida të mëdha, veçanërisht për shkak të varësisë së trashëguar nga burimet ndotëse të energjisë, të cilat janë gjithnjë e më jo efikase dhe të paqëndrueshme. Kjo varësi e bën më të ndërlikuar rrugën e vendit drejt tranzicionit të gjelbër dhe aftësinë e tij për të përmbushur zotimet sipas Agjendës së Gjelbër.

Si palë kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Kosova është zotuar të harmonizojë legjislacionin e saj të energjisë dhe klimës me acquis e Bashkimit Evropian (BE). Ky harmonizim është një hap thelbësor drejt kontributit në qëllimin kolektiv për ta bërë Evropën kontinentin e parë neutral ndaj klimës deri në vitin 2050.

Në vitet e fundit, Kosova ka shënuar përparim në zhvillimin e një kuadri të fortë politik, përfshirë strategji dhe legjislacion primar që synon të përcaktojë objektiva dhe qëllime të qarta për neutralitetin klimatik. Megjithatë, pavarësisht



këtyre zhvillimeve pozitive, realiteti mbetet se zbatimi i këtyre strategjive dhe planeve të veprimit pengohet nga mungesa e kapaciteteve institucionale dhe burimeve. Për shembull, megjithëse Ligji për Mbrojtjen e Natyrës ishte planifikuar për miratim në vitin 2024, ai ende nuk është miratuar. Gjithashtu, në vitin 2023 vetëm 51.8% e objektivave të Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë janë arritur.¹ Kjo pasqyron një shembull më të gjerë të vonesave në mekanizmat e zbatimit. Adresimi i këtij hendeku është thelbësor dhe sigurimi i transparencës dhe llogaridhënies në veprim është fokusi udhëheqës i organizatës sonë dhe shoqërisë civile në tërësi.

Projekti “Kosovo Green Action” është i përkushtuar të avancojë qasjen publike në informacion, të nxisë bashkëpunimin shumëpalësh, të rrisë llogaridhënien dhe të mbështesë shërbime që përputhen me Agjendën e Gjelbër. Projekti përbëhet nga tri komponentë kryesore: (1) zhvillimi dhe mbështetja e mekanizmave bashkëpunues për llogaridhënie sociale; (2) angazhimi i palëve të interesit dhe ndërtimi i kapaciteteve; dhe (3) menaxhimi i projektit, monitorimi, të nxënit dhe shpërndarja e njohurive.

Një mjet kyç i kësaj nisme është “Dokumenti i Zotimit”, një instrument i llogaridhënies sociale i krijuar për të siguruar transparencën në proceset e politikëbërjes në Kosovë. Këto dokumente theksojnë përpjekje konkrete të cilat Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës janë zotuar të ndërmarrin gjatë Forumit të Gjelbër Vjetor.


Zotimet e paraqitura në këtë dokument kanë dalë nga diskutimet në panele dhe sesionet tematike që u fokusuan në klimën dhe energjinë, duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse. Duke përfshirë kontributin e një game të gjerë palësh të interesit – përfshirë përfaqësues të qeverisjes qendrore dhe lokale, sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile (OSHC), mediat dhe akademinë – Forumi i Gjelbër ofroi një platformë për dialog kuptimplotë dhe veprim kolektiv.

Duke qenë se ky është Dokumenti i dytë i Zotimit i publikuar, ai vë theks të veçantë në vlerësimin e përparimit të bërë – ose mungesës së tij – në zotimet e përcaktuara në dokumentin e parë. Ky vlerësim, i kryer gjatë Forumit të dytë të Gjelbër, synon të evidentojë arritjet, të identifikojë boshllëqet dhe të përditësojë zotimet në përputhje me zhvillimet më të fundit. Duke ruajtur këtë cikël të transparencës dhe llogaridhënies, Kosova afrohet më shumë drejt përmbushjes së zotimeve të saj në kuadër të Agjendës së Gjelbër dhe mbështetjes së një të ardhmeje të qëndrueshme dhe neutrale ndaj klimës.

PËRMBLEDHJE

Forumi i parë vjetor i Gjelbër, i mbajtur në dhjetor 2023, shërbeu si platformë për dialog mes palëve të interesit dhe si ngjarja lansuese për Projektin Kosovo Green Action. Diskutimet e zhvilluara në forum informuan përpilimin e Dokumentit të parë të Zotimit, i publikuar në vitin 2024.

Një vit më vonë, Forumi i dytë i Gjelbër vlerësoi përparimin e bërë mbi këto përpjekje dhe identifikoi prioritetet institucionale. Duke u bazuar në diskutimet e forumit të parë, kësaj here panelistët dhe pjesëmarrësit u përqendruan në përparimin e zotimeve të mëparshme, mësimet e nxjerra, boshllëqet dhe prioritetet e institucioneve.



Gjatë Forumit të parë të Gjellbër të mbajtur në dhjetor 2023, Ministria e Ekonomisë mori këto zotime:

Zotimet (2024)	Vlerësimi (2025)
Miratimi dhe fillimi i zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2022-2031, në përputhje me Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane dhe Axhendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, duke siguruar konsistencë me draft Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës.	Strategjia e Energjisë 2022-2031 është miratuar në mars 2023 dhe zbatimi është në vazhdim. Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë së Energjisë u finalizua dhe Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë për periudhën 2023 - 2025 u hartua dhe u miratua në shtator 2023. Janë bërë përpjekje monitoruese për vitin 2023 dhe gjashtëmuorin e parë të vitit 2024 nga Ministria e Ekonomisë.
Krijimi i një kornize ligjore për të adresuar sfidat për mjedisin e energjisë së pastër, me Ligjin për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE) që do të miratohet në TM2/2024.	Ligji për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë u miratua në Prill 2024.
Zhvillimi i ankandeve transparente dhe konkurruese për investimet në BRE, duke përfshirë përfundimin e ankandit diellor 100 MW dhe shpalljen e fituesit në TM1/2024.	Ministria e Ekonomisë shpalli fituesin e ankandit të energjisë diellore 100 MW në mars 2024. Për më tepër, ka një proces ankandi të erës në vazhdim.
Identifikimi i lokacioneve dhe përgatitja e dokumentacionit për ankande shtesë për projektet e energjisë së erës dhe diellit (në vazhdim).	Faza e tretë e studimit të lokacionit (site study) nga BE ka përfunduar (Mars 2024) - E papublikuar. Një nga lokacionet e përzgjedhura për parkun me erë është Kramovik.
Bashkëpunimi në projektin e baterive për ruajtjen e energjisë, financuar nga Llogaria e Sfidës së Mijëvjeçarit në Kosovë (MCA).	Bashkëpunimi për projektin e ruajtjes së baterive me Llogarinë e Sfidës së Mijëvjeçarit në Kosovë (MCA) është në vazhdim.
Inicimi i një projekti 150 MW për energjinë e erës duke përdorur fondet nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) Resilience and Sustainability Facility (RSF) për të ndihmuar në prokurimin e këtyre 150 MW kapacitet të erës.	Progresi i bërë deri më tani është i kufizuar në hartimin e projekteve konkurruese të energjisë së erës.
Zbatimi i tenderit të nisur për ndërtimin dhe funksionimin e një impianti diellor 100 MW në tokë publike, i cili do të përdoret për qëllime tregtare dhe zhvillim energjetik.	Ofertuesi fitues është në proces pajisjeje me leje ndërtimi për ndërtimin e impiantit diellor.
Miratimi i incentivave të efikasitetit të energjisë për sektorin privat dhe familjet, duke u fokusuar në aspektet sociale dhe familjet me të ardhura të ulëta (incentiva shtetërore) dhe shfrytëzimin e programeve ekzistuese të BE-së në Kosovë (TM4/2024).	Ministria e Ekonomisë nënshkroi projektin "Zbatimi i Masave të Efikasitetit të Energjisë për Ndërtesat Sociale Shumë-banesore", një investim prej 5.5 milionë euro në efikasitet energjetike, nga i cili do të përfitojnë 785 familje ose rreth 3400 qytetarë. ²
Finalizimi i fazës së tretë të studimit gjithëpërfshirës mbi burimet alternative të qëndrueshme të energjisë në përputhje me tranzicionin e qëndrueshëm të gjellbër në Evropë, (TM1/2024).	Faza e tretë e studimit u përfundua gjatë vitit 2024.

² Ministria e Ekonomisë, Lajme. E qasshme në: <https://m.eks-gov.net/en/blog/e5-5-million-investment-for-785-families-in-the-implementation-of-energy-efficiency-measures-for-social-multi-apartment-buildings/>

Gjatë Forumit të parë të Gjelbër të mbajtur në vitin 2023, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës mori zotimet e mëposhtme:

Zotimet (2024)	Vlerësimi (2025)
Finalizimi dhe miratimi i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (TM4/2024).	Ligji për Mbrojtjen e Natyrës mbetet i pamiratuar, pa progres në harmonizimin e legjislacionit kombëtar me direktivat e BE-së. Zbatimi lokal është i pamjaftueshëm, duke kufizuar aftësinë e Kosovës për të përmbushur standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së mjedisit.
Miratimi i Projektligjit për Ujërat e Kosovës (TM4/2024).	Ligji për ujërat e Kosovës nuk është në përputhje me Direktivën Kornizë të BE-së për Ujërat dhe ende nuk është miratuar.
Miratimi i Planit të Veprimit për Cilësinë e Ajrit (TM4/2024).	Përkundër miratimit të planit, zbatimi nuk ka treguar efekte të dallueshme, pasi Kosova mbetet një nga vendet më të ndotura në rajon.
Dizenjimi i masave për kontrollin e ndotjes së ajrit për Prishtinën dhe aglomeratat e tjera më të rëndësishme dhe zonat e ndjeshme (TM4/2024).	Nuk ka të dhëna të disponueshme.
Zhvillimi dhe fillimi i zbatimit të një plani gjithëpërfshirës të zhvillimit të kapaciteteve institucionale për zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve (TM4/2024).	MESPI ka krijuar një Trup Monitorues për të gjitha objektivat e Strategjisë (2024-2035) për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve për vitet 2021-2030, së bashku me planet e veprimit për 2021-2023 janë hartuar dhe miratuar dhe zhvillimi i planit të veprimit për vitin 2026-2024 është në proces. ³
Ndryshimi i strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve për të përfshirë objektivat e riciklimit, masat për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme, bashkëpunimin ndërkomunal (TM4/2024).	Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve (2021-2030) është ndryshuar në Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2024-2035 në dhjetor 2024. Amendamenti përcakton objektiva më specifike për riciklimin dhe thekson një plan të detajuar të menaxhimit për mbetjet e rrezikshme. Ka përfunduar funksionalizimi i marrëveshjeve ndërkomunale për menaxhimin e mbeturinave; Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkomunal është i vendosur.
Transpozimi në legjislacionin e Kosovës i direktivave të BE-së për rrjedhën e mbeturinave (TM4/2024).	Strategjitë e menaxhimit të mbetjeve po rishikohen për t'u përafëruar me direktivat e BE-së. Zbatimi aktual mbetet i pasigurt dhe pjesëmarrja e publikut në riciklimin dhe reduktimin e mbetjeve është ende e ulët.
Zbatimi i fushatave të ndërgjegjësimit të publikut (TM4/2023 dhe i vazhdueshëm).	Pavarësisht disa përpjekjeve për ndërgjegjësimin përmes videove të shkurtra të transmetuara në televizionin kombëtar, mungojnë iniciativat me tematika specifike.
Zbatimi i strategjisë së ndryshimeve klimatike dhe planit të veprimit për ndryshimet klimatike.	Të dhënat e monitorimit nuk janë të disponueshme.
Përgatitja e një inventari të emetimeve të gazeve serë që mbulojnë periudhën deri në vitin 2021 (TM2/2023).	Inventari përgatitet dhe publikohet çdo dy vjet.

3 Ekonomia qarkore Profili i Shtetit 2024 – Kosovë. E qasshme në: https://www.eea.europa.eu/en/topics/in-depth/circular-economy/country-profiles-on-circular-economy/circular-economy-country-profiles-2024/kosovo_2024-ce-country-profile_final.pdf/@download/file

Një vit më vonë, Forumi
i dytë i Gjelbër vlerësoi
përparimin e bërë mbi
këto përpjekje dhe
identifikoi prioritetet
institucionale.



ZOTIMET

Duke reflektuar mbi përmbushjen e zotimeve të mëparshme, si Ministria e Ekonomisë ashtu edhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës i kanë ripërtërirë angazhimet e tyre, duke përfshirë veprimet që janë përcaktuar si prioritete për këtë vit.

Ministria e Ekonomisë, siç u theksua në Forumin e 2-të Vjetor të Gjelbër, angazhohet për:

- 1 Hartimin dhe miratimin e Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë për periudhën 2026–2028.
- 2 Finalizimin e raportit të progresit për monitorimin e Strategjisë së Energjisë për vitin 2024.
- 3 Hartimin dhe finalizimin e Raportit të Progresit për periudhën 2023–2024 të Programit për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë së Kosovës.
- 4 Finalizimin e Udhëzimeve Administrative ndihmëse për Ligjin për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, bazuar në planin e akteve nënligjore për vitin 2025.
- 5 Finalizimin e procesit të fazës RFP për tenderin e parë për energji me erë, ndjekur nga vlerësimi i ofertuesve dhe shpallja e fituesit.
- 6 Pajisjen me lejet e nevojshme për ndërtimin e impiantit diellor 100 MW në Kramovik nga konsorciumi i fituesve të ankandit në vitin 2024.
- 7 Përditësimin periodik të faqes zyrtare të ministrisë për shpërndarjen e informacionit lidhur me subvencionet për masat e efikasitetit energjike.



Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, siç u theksua në Forumin e 2-të Vjetor të Gjelbër, zotohet për:

1

Rishikimin dhe përfshirjen e komenteve nga procesi i konsultimit për Planin Kombëtar për Energji dhe Klimë (NECP), finalizimin e dokumentit dhe dorëzimin e versionit të përditësuar në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për miratim.

2

Miratimin e Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe krijimin e një kuadri mbikëqyrës të fuqishëm për të siguruar zbatimin dhe zbatueshmërinë efektive.

3

Përfundimin e një vlerësimi të cenueshmërisë klimatike për të identifikuar zonat më të rrezikuara të mbrojtura për parandalimin e fatkeqësive natyrore, përtej atyre të përfshira në hartën e rrezikut nga përmbytjet.

4

Hartimin dhe finalizimin e planit të menaxhimit për pellgun ujqor Ibër, për të siguruar menaxhim dhe mbrojtje të qëndrueshme të burimeve ujore.

5

Rishikimin dhe përmirësimin e strategjive për menaxhimin e përmbytjeve përmes vlerësimit të rolit, koordinimit dhe mekanizmave të reagimit të institucioneve përkatëse.

6

Certifikimin e administratorit përgjegjës për mbikëqyrjen e Sistemit të Rimbursimit të Depozitave (DRS), për të forcuar reduktimin e mbeturinave dhe nismat për riciklim.

7

Zbatimin e fushatave të targetuara për ndërgjegjësim publik, duke siguruar pjesëmarrje gjithëpërfshirëse të të rinjve dhe nxitjen e një angazhimi më të gjerë për mjedisin.



PËRFUNDIME

Institucionet kanë bërë përparim të konsiderueshëm në përmbushjen e zotimeve të vendosura më parë, edhe pse disa sfida vazhdojnë të pengojnë zbatimin e plotë. Ndërkohë që disa përpjekje janë nisur dhe zhvilluar sipas afateve të planifikuara, të tjera janë përballur me vonesa për shkak të kapaciteteve të kufizuara institucionale ose pasigurisë rregullative. Pavarësisht këtyre sfidave, përkushtimi i institucioneve për të bashkëpunuar në hartimin e veprimeve të reja është i dukshëm dhe i lavdërueshëm. Kjo frymë bashkëpunimi krijon një bazë të fortë për planifikim dhe zbatim më efektiv në të ardhmen.

Paralelisht, edhe pse angazhimi publik në nismat e gjelbra është rritur, ka një nevojë të qartë për mekanizma më të strukturuar dhe gjithëpërfshirës për të siguruar pjesëmarrje domethënëse. Sigurimi i përfshirjes aktive të komuniteteve lokale, bizneseve dhe OSHC-ve në zhvillimin e politikave është thelbësor për një ndikim të gjerë dhe të qëndrueshëm. Për ta mbështetur këtë, prezantimi i raporteve vjetore të progresit me Tregues të Performancës Kyçe (KPI) qartë të përcaktuar do të jetë thelbësor. Këta tregues mund të shërbejnë si mjete llogaridhënieje dhe si pika referimi për të ndjekur efektivitetin e angazhimeve me kalimin e kohës.

Qasja në financim të gjelbër mbetet një sfidë madhore. Vlerësimi i mesëm i projektit theksoi rëndësinë e krijimit të partneriteteve publike-private si një qasje strategjike për të mobilizuar investime për energjinë e ripërtëritshme dhe projektet e përqendruara në qëndrueshmëri.



Sigurimi i përfshirjes aktive të komuniteteve lokale, bizneseve dhe OSHC-ve në zhvillimin e politikave është thelbësor për një ndikim të gjerë dhe të qëndrueshëm.



